



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Presence in Albania

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONGRESIN E PARË TË NOTERËVE SHQIPTARË

"Besimi dhe siguria te noterët – një garanci ligjore për zhvillimin social dhe ekonomik dhe për integrimin evropian të vendit"

04 maj 2012

I nderuar Kryeministër Berisha,
Ministër Halimi,
Të nderuar miq,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të falënderoj, në fillim, organizatorët e këtij Kongresi të Parë të Noterëve Shqiptarë, që më dhanë mundësinë t'ju drejtohem këtë mëngjes.

Jam veçanërisht i kënaqur që ndodhem këtu sot në dritën e marrëdhënieve të shkëlqyera që ekzistojnë midis Prezencës së OSBE-së në Shqipëri me Dhomës Kombëtare të Noterëve.

Forcimi i pozicionit të noterëve, si një element kyç në sektorin ligjor, është një nga qëllimet strategjike të Prezencës së OSBE-së në ndihmën për autoritete kombëtare për konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Në fakt, Prezenca e OSBE-së është përfshirë në mënyrë aktive në reformën e legjislacionit për noterët.

Në vitin 2008, ne ishim pjesë e Grupit të Punës udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë, ku bëmë komente me shkrim për hartimin e legjislacionit.

Prezenca e OSBE-së beson se noterët duhet të luajnë një rol vendimtar në sektorin ligjor, një rol i reflektuar edhe në statusin e pavarur që gëzon ky profesion.

Përmes pavarësisë së tyre, noterët janë vërtet gardianët e të drejtave të qytetarëve.

Në kryerjen e punës së tyre profesionale, ata janë të lirë dhe objektivë dhe u duhet besuar pikërisht për paanshmërisë e tyre.

Megjithatë, ky status i veçantë vjen edhe me disa përgjegjësi solemne.

Në marrjen përsipër të detyrave të tyre, ata duhet të udhëhiqen nga pesë parime profesionale kyçe: integriteti, paanshmëria, e vërteta, barazia dhe konfidencialiteti.

Kuptohet që noterët nuk punojnë krejtësisht i veçuar.

Puna e tyre profesionale lehtëson ngarkesën e organeve të tjera ligjore.

Puna e noterit kontribuon shumë në reduktimin e mosmarrëveshjeve post-kontraktuale dhe kështu edhe në nevojën për t'iu drejtuar rrugëve ligjore në gjykata. Ajo redukton pasigurinë dhe kostot.

Reformat e ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë për përforcimin e kompetencave të zyrave noteriale në lidhje me shërbimet e ofruara nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, janë inkurajuese.

E megjithatë, roli i noterëve meriton të zhvillohet më tej, pasi ka fusha të tjera, ku noterët mund të luajnë dhe unë besoj se duhet të luajnë një rol të konsiderueshëm.

Për shembull, në bazë të vëzhgimeve të aktivitetit të gjykatave nga OSBE-ja, dhe në veçanti të ngarkesës së tyre, mund të merret në konsideratë transferimi i disa kompetencave nga gjykatat te noterët, si dhënia e vërtetimeve të trashëgimisë apo regjistrimi i organizatave joqeveritare.

Kjo jo vetëm do të ofronte një shërbim publik më të shpejtë dhe më eficient, por mundet edhe të çlirojë gjykatat nga ngarkesa që sjellin këto akte.

Çdo zgjerim i fushës së veprimtarisë së noterëve duhet reflektuar gjithmonë si në trajnime të specializuara profesionale edhe në mbikëqyrjen e qartë e të strukturuar të shërbimeve noteriale.

Arsimi dhe formimi profesional kanë një rol thelbësor në ndërtimin dhe zhvillimin e profesionalizmit.

Një theks i veçantë i duhet vënë edhe arsimimit, formimit dhe procesit të emërimit të gjithë noterëve.

Duke marrë parasysh edhe vlerën e pavarur të akteve noteriale, mbikëqyrja e brendshme e shërbimeve noteriale nga një Dhomë Kombëtare e përforcuar e Noterëve si dhe nga institucionet shtetërore mund të rezultojë e dobishme.

Në këtë kontekst, si një gardian i të drejtave të gjithë qytetarëve, nevojitet një përmirësim i mekanizmave të inspektimit të noterëve, veçanërisht për inspektimin e dokumenteve noteriale.

Çdo shkelje duhet të çojë në masa disiplinore më të ashpra sepse kjo mund të jetë mënyra e vetme efektive për të përforcuar besimin e publikut në sistemin ligjor.

I nderuar Kryeministër,
Ministër Halimi,
Të nderuar miq,
Zonja dhe zotërinj,

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri shpreson të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me Dhomën Kombëtare të Noterëve dhe Ministrinë e Drejtësisë në përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit për noterët.

Ju falënderoj dhe më lejoni t'ju uroj shumë sukses në Kongresin e parë të noterëve shqiptarë.